



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:296425

Datë: 05.04.2022

Numri i dokumentit: 02884681

PKR.nr.5/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti për Krime të Rënda, kryetari i trupit gjykues Shaqir Zika, me procesmbajtësen Nushe Kadrija – sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale ndaj të akuzuarve S.M. dhe H.M. që të dy nga fshati M., Komuna Prizren, dhe M.M., nga fshati R., Komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale falsifikim i parasë nga neni 296 par.2 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti për Krime të Rënda, me numër PP/I-nr.271/2021, të datës 17.01.2022, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar me datë 16.02.2022, në prezencën e Prokurores së shtetit Dëshire Jusaj, si dhe të të pandehurit S.M., H.M. së bashku me mbrojtësin av. Sefer Morina avokat nga Prizreni, i caktuar sipas autorizimit, si dhe i pandehuri M.M., në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa **me datën 05.04.2022** përpilojë këtë:

A K T G J Y K I M

Të pandehurit:

1. **S.M.**, i biri i J., e ëma Z., e gjinisë E., i lindur me datën..., në fshati M., Komuna e Prizrenit, ku edhe tani jeton, i martuar i ati i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, turk, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal:..

2. **H.M.**, i biri i S., e ëma N., e gjinisë M., i lindur me datën..., në fshati M., Komuna e Prizrenit, ku edhe tani jeton, i martuar i ati i dy fëmijëve, ka të kryer fakultetin e edukimit, i gjendjes së mesme ekonomike, turk, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal:...

3. **M.M.**, i biri i Sh., e ëma R., e gjinisë B., i lindur me datën... në fshatin R., Komuna e Rahovecit, ku edhe tani jeton, i martuar i ati i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal:..

J A N Ë F A J T O R

I akuzuari: S.M.

I. Me datë të pacaktuar të muajit Qershor e deri me dt.04.10.2021, në cilësinë e tregtarit, duke e ditur se paraja është e falsifikuar, ka marrë dhe vë në qarkullim, e ka përdorur dhe poseduar për të vërtetë, në atë mënyrë i'a jep djalit të tij – të pandehurit H.M. monedhën prej 100 Euro për të bërë pagesën e rrymës dhe se në këtë mënyrë si tregtar shumë vjeçar i shitjes së produkteve bujqësore duke pasur mundësinë e të qenurit në dijeni se paraja është e falsifikuar ka vë në qarkullim për ta përdorë për të vërtetë duke i'a dhënë po këtë para djalit të tij H., për të bërë pagesë të rrymës, ashtu që monedha me nr. Serik X14485231244 nga Ekzaminimi i Agjensionit për Forenzikë nr. AKF/2021-3055/2021-2941 të dt.12.11.2021, rezulton nga konstatimi dhe mendimi përfundimtar se është falsifikim i plotë.

-Me çka ka kryer veprën penale falsifikim i parasë nga neni 296 par.2 të KPRK-së.

I akuzuari: H.M.

II. Me datë, kohë, dhe mënyrë të përshtuar si në dispozitivin e I- të këtij Aktgjykimi më pas i pandehuri ka shkuar në Agjensionin “. . .” në Rahovec, duke ditur se paraja është e falsifikuar, dhe ka dorëzuar shumë prej 100 Euro, duke vë kështu në qarkullim për të kryer pagesë të rrymës edhe pse në dijeni se monedhën prej 100 Euro të cilën i'a kishte dhënë babai S.M., nuk është në rregull por ishte pajtuar dhe vë në qarkullim për të bërë pagesë me dt.04.10.2021 edhe pse pronari Agjensionit – i pandehuri M.M. i'a bën të ditur se kjo monedhë nuk është në rregull por mirët vesh me pronarin që të njëjtën ta vë në qarkullim për të vërtetë dhe që më pas nga Ekzaminimi nga Agjensionit për Forenzikë me numër AKF/2021-3055/2021-2941 të dt.12.11.2021 rezulton se monedha prej 100 Euro, me numër serik X14485231244 nga ekzaminimi përfundimtar rezulton me falsifikim të plotë.

-Me çka ka kryer veprën penale falsifikim i parasë nga neni 296 par.2 të KPRK-së.

I akuzuari: M.M.

III. Me datë 04.10.2021 në cilësinë e pronarit të “. . .” në Rahovec, duke ditur se paraja është e falsifikuar, e merr dhe vë në qarkullim duke e përdorë për të vërtetë, në atë mënyrë që ditën kritike pasi i ka shkuar i pandehuri H.M., në cilësinë e klientit për të bërë pagesën e rrymës dhe i prezanton monedhën prej 100 Euro, i pandehuri M.M., me të vërejtur monedhën siç i bëhet me dije edhe nga punëtorja e tij se monedha nuk ishte si monedhat e tjera i'a bën të ditur klientit të tij duke i thënë se: “kjo para nuk është në rregull”, dhe e fotografon me telefon dhe i thotë se: “nëse kjo para do të del e falsifikuar ju do të përgjigjeni”, ashtu që merren vesh të dytë mes vete për ta provuar paranë në bankë ku i pandehuri M. pas orarit të punës bën deponimin e saj në Bankën BPB në Rahovec e që më pas njoftohet nga zyrtari përgjegjës i bankës se monedha prej 100 euro e deponuar me dt. 04.10.2021 është konfiskuar për dyshim falsifikimi për çka më pas nga Ekzaminimi i bërë nga Agjensionit për Forenzikë nr. AKF/2021-3055/2021-2941 të dt.12.11.2021 rezulton se monedha prej 100 Euro, me nr. serik X14485231244, është falsifikim i plotë.

-Me çka kishte për të kryer veprën penale falsifikim i parasë nga neni 296 par.2 të KPRK-së.

Andaj Gjykata me aplikimin e neneve 6, 7, 17 par 1, 38, 39, 40, 42, 44, 69, 70, 71. 72 dhe nenit 296 par.2 të KPRK-së, dhe neneve 359 par. 2, 366, të KPRK-se të akuzuarit i

G J Y K O N:

Të akuzuarin S.M., ME DËNIM ME BURGIM, në kohëzgjatje prej tre (3) muajve, i cili dënim me kërkesë e të pandehurit konform nenit 44 të KPRK-së, Dënimi me burgim **I ZËVENDËSOHET** me **DËNIM ME GJOBË** në shumë prej katërqind (400) Euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mundë të paguaj gjobën, gjykata të njëjtin dënim me gjobë do të ia zëvendëson me dënim burgimi në kohëzgjatje prej njëzet (20) ditëve duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg nga njëzet (20) Euro.

Të akuzuarin H.M., ME DËNIM ME BURGIM, në kohëzgjatje prej tre (3) muajve, i cili dënim me kërkesë e të pandehurit konform nenit 44 të KPRK-së, Dënimi me burgim **I ZËVENDËSOHET** me **DËNIM ME GJOBË** në shumë prej katërqind (400) Euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mundë të paguaj gjobën, gjykata të njëjtin dënim me gjobë do të ia zëvendëson me dënim burgimi në kohëzgjatje prej njëzet (20) ditëve duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg nga njëzet (20) Euro.

Të akuzuarin M.M., ME DËNIM ME BURGIM, në kohëzgjatje prej tre (3) muajve, i cili dënim me kërkesë e të pandehurit konform nenit 44 të KPRK-së, Dënimi me burgim **I ZËVENDËSOHET** me **DËNIM ME GJOBË** në shumë prej katërqind (400) Euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mundë të paguaj gjobën, gjykata të njëjtin dënim me gjobë do të ia zëvendëson me dënim burgimi në kohëzgjatje prej njëzet (20) ditëve duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg nga njëzet (20) Euro.

Ndaj të akuzuarit H.M., konfiskohet: monedha prej 100 Euro, me nr. serik X14485231244, si objekt i veprës penale, dhe e njëjta monedhë do të shkatërrohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Detyrohen të akuzuarit, që ti paguajnë shpenzimet e paushallit gjyqësorë secili veç e veç shumë me nga tridhjetë (30) Euro, si dhe për programin për kompensimin e viktimave të krimit secili veç e veç shumë me nga pesëdhjetë (50) Euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokurorisë Themelore në Gjakovë- Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzë PP/I-nr.271/2021, të datës 17.01.2022, kundër të akuzuarve S.M., H.M. që të dy nga

fshati MM, Komuna e Prizrenit dhe të akuzuari M.M., nga fshati RM, Komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale falsifikim i parasë nga neni 296 par.2 të KPRK-së,

Gjyqtari ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datën 16.02.2021, në të cilin kanë marr pjesë Prokurores së shtetit Dëshire Jusaj si dhe të të pandehurit S.M., H.M. së bashku me mbrojtësin av. Sefer Morina avokat nga Prizreni, i caktuar sipas autorizimit, si dhe i pandehuri M.M..

Prokurorja e shtetit Dëshire Jusaj, gjatë shqyrtimit fillestar ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarve, andaj ka propozuar që të njëjti të shpallën fajtor dhe të dënohen sipas ligjit.

I akuzuri S.M. gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se deklaron se e pranon fajësinë për veprat penale për të cilën akuzohet, ngase pasi që paraja ka dal e falsifikuar atëherë e pranoi fajësinë dhe i propozoi gjykatës që të më shqiptoi një dënim sa më të butë shprehi keqardhjen dhe premtoj se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme penale.

I akuzuari H.M. gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprat penale për të cilën akuzohet, shprehi keqardhje për rastin dhe premtoj se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme penale.

I akuzuari M.M. gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprat penale për të cilën akuzohet, shprehi keqardhje për rastin dhe premtoj se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme penale.

Meqenëse të pandehurit e kanë pranuar fajësinë, ftohet prokurorja e shtetit si dhe mbrojtësi i të pandehurit H.M. av. Sefer Morina që të japin mendim rreth pranimit të fajësisë.

Prokurorja e shtetit Dëshire Jusaj duke dhënë mendim rreth pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarve ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë së të akuzuarve në këtë seancë gjyqësorë, pranimi i fajësisë i të akuzuarit S.M., H.M., dhe M.M., është bërë nga të akuzuarit në mënyrë të vullnetshëm pa presion, duke qenë të vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë pranimi i fajësisë ka mbështetje në provat materiale dhe personale në bazë të të cilave edhe është ngritur aktakuza, i akuzuari H. është konsultuar mjaftueshëm me mbrojtësin e tij andaj i ka propozuar gjykatës që ta aprovoi pranim e fajësisë duke vlerësuar rrethanat rënduese dhe lehtësuese me rastin e vendosjes mbi sanksionin penale.

Mbrojtësi i të akuzuarit H.M. av. Sefer Morina duke dhënë mendim rreth pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit tim, pasi që një pranim të tillë i mbrojturi imë e ka bërë me këshillimin paraprak me mua si mbrojtës, pranimi i fajësisë është bërë me shprehjen e lirë të vullnetit të tij, pa ndonjë premtim, ndikim, apo vënie në lajthim, e po ashtu i mbrojturi imë i ka kuptuar edhe pasojat e pranimit të fajësisë, andaj propozojmë gjykatës që ta aprovoi pranimin e fajësisë.

Me rasti të caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të ketë parasysh që ndaj të mbrojturit tim të bëjë zbutjen e dënimit konform nenit 72 par.1 nënpar.1.5 të KPP-së, pasi që në këtë çështje penale nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat rënduese e po ashtu kemi të bëjmë vetëm me rrethanat lehtësuese të cilat ekzistojnë tek i mbrojturi imë dhe atë duke marr parasysh se i mbrojturi imë veprën penale e ka kryer me dashje eventuale dhe se sikur kjo vepër penale të parashihej se mund të kryhej edhe pa kujdesia, se gjatë ndërmarrjes së veprimeve të kryerjes së kësaj vepre penale i

mbrojturi im nuk ka pasur ndonjë motiv të caktuar për përfitim apo dëmtrim të dikujt, faktit se i mbrojturi imë asnjë herë më parë nuk ka ra ndesh me ligjin dhe nuk ka qenë i dënuar bile as që ka qenë ndonjëherë nën hetime për çfarëdo veprë penale, është i gjendjes së dobët ekonomike, ngase jeton dhe mban familjet nga të ardhurat të cilat i realizon si punëtor i arsimit, shprehjen e keqardhjes për veprimet e kryera, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra penale të tilla apo tjera dhe se do të jetë shumë më i kujdesshëm në të ardhmen nëse do të ketë rast me qarkullimin e ndonjë paraje sikurse në rastin konkret.

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, kryetari i trupit gjykues pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve për veprat penale për të cilat janë ngarkuar me aktakuzë, ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë kryetari i trupit gjykues konstatoi se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga të akuzuarit, i akuzuari H.M. pas shpjegimeve të mjaftueshme nga ana e mbrojtësit të tij av. Sefer Morina, si dhe pas shpjegimeve të mjaftueshme nga gjykata, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë kryetari i trupit gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike: se të akuzuarit S.M., H.M. dhe M.M. me dashje kanë kryer veprën penale falsifikim i parasë nga neni 296 par.2 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruara si në dispozitivet e këtij Aktgjykimi.

Duke u bazuar në këto që janë cekur më lartë, kryetari i trupit gjykues të akuzuarin S.M., H.M. dhe M.M., i ka shpallur fajtorë ngase në veprimet e tyre të përshkruara si në dispozitivin I,II dhe III, të aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale falsifikim i parasë nga neni 296 par.2 të KPRK-së dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarit të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tyre.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit Gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese Gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarve: në gjykim ka pasur qëndrim tejet korrekt, pendimin e tyre, ndërsa si rrethanë posaçërisht lehtësuese ka marrë parasysh pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestarë, si dhe faktin se më parë nuk kanë qenë të dënuar për ndonjë veprë tjetër penale, kanë shprehur pendimin e thellë për veprën e kryer, të cilat rrethana kanë ndikuar që gjykata ti aplikoi dispozitat e zbutjes së dënimit konform nenit 72 par.1.4 të KPRK-së, të akuzuarve iu ka shqiptuar dënimin në minimumin e përcaktuar ligjor dhe atë dënim në kohëzgjatje prej 6 muajve, e të cilat dënime me kërkesën dhe pëlqimin e të akuzuarve gjykata konform nenit 44 dënimin me burg i ka zëvendësuar me dënim me gjobë me shpresë dhe bindje se me dënimin e shqiptuar me gjobë do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së dhe ky dënim si i tillë i shqiptuara sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprat penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedojnë të akuzuarit dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikoj në parandalimin e të akuzuarve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tyre, do të

parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Konform nenit 92 lidhur me nenin 296 par.6 të KPRK-së, para e falsifikuar konfiskohet në mënyrë të përhershme dhe e njëjta do të asgjësohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Duke e pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe duke u bazuar në nenet 451 paragrafi 1 dhe 453 të KPP-së si dhe konform nenit 39 paragrafi.3 nënparagrafi.3.2 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, kryetari trupi gjykues ka vendosur që i akuzuari t'i paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor si dhe shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, komfor nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti për Krime të Rënda -
PKR.nr.5/22, të datës 05.04.2022

Procesmbajtësja,
Nushe Kadrija

Kryetari i trupit gjykues,
Shaqir Zika

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.